

# STATUTI I SHOQERISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

**"Electro TECH" SH.P.K**



## **Neni 1**

**FORMIMI I SHOQERISE**  
Formohet shoqeria  
**"Electro TECH"SH.P.K**

(Që këtu e më poshtë referuar si "Shoqëria" , e cila themelohet nga ortakët:

**1-AURELDA SIMON XHAFI**, e datëlindjes 29.03.1993, lindur ne SHales-Elbasan, banuese ne Tirane, madhore, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me pasaporte personale për identifikim nr. BJ 0318705 dhe nr. Personal J 35329011H.

**2-MARJUS MINA MIHALI**, i datëlindjes 09.03.1993, lindur ne Bubullime-Lushnje, banues ne Tirane, madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me ID për identifikim, me nr. Personal J30309031D.

## **Neni 2**

**SELIA E SHOQËRISË**

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën, rrugën "Ismail Qemali, nd.40, H.72., Ap.21, Yzberish-Kashar, 1050-Tirane, tel cel 0695855372, tel cel 0672065726, Imeil "[Electrotech .al @ gmail. Com](mailto:Electrotech.al@gmail.com).

Shoqëria ka të drejtë të hapë degë apo filiale, zyra përfaqësimi, në të gjithë vendin gjatë aktivitetit të saj, brenda ose jashtë territorit të R.SH-së.

## **Neni 3**

**KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË EKONOMIKE**

Kohëzgjatja e aktivitetit të shoqërisë do të jetë për një periudhë kohore  
TE PA CAKTUAR.

**Neni 4**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është si më poshtë:

**Në fushën e energjisë, brenda dhe jashtë Shqipërisë**

Studim projektim, prodhim, ndërtim dhe instalim i sistemeve të prodhimit elektrik nga burime të rinovueshme . Menaxhim dhe aktivizim i projekteve financiare të aktiviteteve të sipërpërmendura.

- Sipërmarrje e ndërtimeve për llogari e të tretëve dhe konkretisht të ndërtimit të hidrocentraleve dhe impianteve të prodhimit të energjisë elektrike duke i ofruar klientëve të saj shërbimin e plote që nga fazat e para të projektimit, ndërtimit deri në kompletimin e këtyre strukturave me të gjitha pajisjet, makineritë dhe instalimet e nevojshme duke i dorëzuar objektet në gjendje funksionale.
- Shërbim mirëmbajtje parandaluese, riparuese dhe rinovuese të objekteve të prodhimit të energjisë si dhe të asistencës studimore, teknike apo dhe të trajnimeve të personelit që do të punësohet në pajisjet dhe makineritë specifike të këtyre objekteve të prodhimit të energjisë elektrike të cilat mund të jenë Hidrocentrale, Centrale Eolike, Fotovoltaike etj sipas rastit të projektit. Pra çdo gjë që ka lidhje me energjinë elektrike.
- Ndërmarrja e veprave që kanë lidhje me instalimet elektrike dhe mekanike, si dhe çdo lloj instalimi elektrik të rrymave të forta dhe të dobëta. Ofrimi i shërbimeve elektrike, riparime të instalimeve elektrike, mirëmbajtje të tyre. Tregti e çdo lloj materiali elektrik dhe mekanik.
- Ndërmarrja e veprave të rrjeteve të telekomunikacionit të brendshme dhe të jashtëm, rrjete me fibra optike, rrjete telefonike, struktura kabllore të ndërtesave. Çdo lloj instalimi elektromekanik të ndërtesave si dhe tregtimi i çdo lloj materiali.
- Prodhim, shitje dhe tregtim i energjisë nga burime të rinovueshme dhe në veçanti të energjisë elektrike nga impiante fotovoltaike, eolike, hidroelektrike dhe/ ose të ngjashme, me mulli ere etj, në Shqipëri dhe jashtë saj.





- Shitja e energjisë elektrike klientëve dhe blerja e energjisë elektrike nga operatore të ndryshëm private apo shtetërore brenda dhe jashtë vendit.

- Transmetimi i energjisë elektrike në sistemin e tensionit të lartë, funksion i cili përfaqëson transmetimin ose interkonjiksioni ndërkombëtar etj.

Aktivitet në fushën ndërtimore, për projektim e zbatim, si p.sh." punime dheu, muratore, betoni, B/arme të zakonshme, punime shembje etj.

Ndërtime civile, industriale, turistike, bujqësore etj., dhe kompletimi me instalime të nevojshme për to, si dhe çdo lloj ndërtimi që ka të bëjë me fushën e energjisë elektrike.

-Punime restaurimi, mirëmbajtje e punime shërbimi të zakonshme të sistemit komunal.

-Studime urbanistike, plane rregulluese të qendrave të banimit pjesor, urbanistik, plan vendosje të objekteve të veçante.

-Tregtim import eksport për mallra të ndryshme industriale, ushqimore, kimike, ndërtimore, dhe tregtim të metaleve të ndryshme dhe minerale dhe energjetikë.

### **Ne fushën e shërbimeve, brenda dhe jashtë Shqipërisë.**

- Kërkim, zhvillim, formim, konsulencë, projektim industrial të zhvilluara nga vet kompania dhe në shërbim të aktivitetit të saj për ndërtimin, riparimin, modifikimin, asistencë, përfaqësim, menaxhim, shitjen e metodologjive teknike, programeve, komponentëve, pajisjeve, sistemeve dhe impianteve në sektorët: elektrik, elektronik, elektromekanik, informatikë, termik, hidraulik, makineri, ndërtime, energji, menaxhim teknologjik, komunikim, rregullim, automatizim, kontroll, tel kontroll dhe telekomandim, super vizim.

- Projektim për llogari të vete si dhe për të shërbyer aktivitetit të saj në lidhje me të tretet. Ndërtim, riparim, shitje me shumicë dhe pakice, shpërndarje, përfaqësim aparaturash elektronike, elektromekanike, elektrike, pajisje dhe makineri telekomunikimi, komponent elektronik matjesh.

- Zhvillimin e studimeve, kërkimeve, matjeve, testeve, përpunimin dhe raportimin e të dhënave dhe informacioneve të

grumbulluara për llogari të vetë ose të të tretëve lidhur me sektorin e industrisë, energjetikës etj.

- Organizimin e trajnimeve të ndryshme profesionale si për stafin e vet por dhe për të tretë në lidhje me industrinë dhe aktivitetin e ndërmarrjeve në përgjithësi sipas lejeve dhe licencave të kërkuara sipas rasteve.

### **Ne fushën e hidrokarbureve dhe mineraleve, brenda dhe jashtë Shqipërisë.**

- Konsulentë teknike, ndërmjetësi tregtar, studim tregu, studime legjislatore në lidhje me industrinë e naftës. Shpime për studime të nëntokës dhe për hapje puse hidrologjike. Tregtim me pakice të karburanteve dhe vajrave lubrifikante. Eksport-import i karburanteve dhe nënprodukteve të tyre, hidrokarbureve në përgjithësi. Përpunim dhe rafinim i naftës. Shitje të karburanteve të të gjitha llojeve, blerje, importim, eksportim, transportim, shpërndarje me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikanteve, etj. Ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave, etj.

- Blerje, importim, shitje e naftës dhe vajrave minerale të pa përpunuar, transportimin për llogari të vetë dhe për llogari të të tretëve, depozitim përzierjen, trajtimin, shitjen, shpërndarjen me shumicë të qymyrit, gazit, lubrifikanteve, produkteve të naftës dhe naftokimike, duke përfshirë këtu edhe bitumet. Blerjen shitjen qiradhënien ndërtimin dhe administrimin e impianteve, depozitave dhe administrimin e ndërtesave dhe pasurive të veta të paluajtshme.

### **Ne fushën e tregtisë, brenda dhe jashtë Shqipërisë.**

- Import-eksport e tregtim me shumicë e pakice i mallrave të ndryshëm industriale si pajisje elektronike e elektrike, materiale dhe lende ndërtimi, inerte, makineri, pajisje, linja prodhimi të llojeve të ndryshme, automjete të tonazheve të ndryshëm e pjesë këmbimi makinash dhe makinerish.

- Në shërbim të aktiviteteve të mësipërme do të kryej dhe transportin e mallrave, makinerive, pajisjeve, personave etj. për llogari të vetë apo të të tretëve, me mjete transporti të vetat apo të të tretëve.

### **Neni 5**

Kjo shoqëri mund të ndryshojë emërtimin e saj, vendqëndrimin, objektin e aktivitetit, të shtojë ortakë, të rrisë kapitalin sipas vendimeve





të ortakëve dhe parashikimeve të ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

#### **Neni 6**

### **KAPITALI I SHOQËRISË**

Kapitali fillestar i shoqërisë është 100.000 (njqind mijë) Lekë, i ndarë në dy pjesë (kuota), si më poshtë:

Znj. Aurelda XHafa, zotëron një pjesë (kuotë), në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë;

Zoti Marjus Mihali, zotëron një pjesë (kuotë), në masën 50 % të kapitalit të shoqërisë.

Ortakët mund të vendosin të rrisin kapitalin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Detyrimet e ortakut kundrejt shoqërisë do të mbulohen vetëm me pjesën e kapitalit të paguar prej tij.

#### **Neni 7**

Kapitali i shoqërisë mund të shtohet ose të zvogëlohet sipas dispozitave ligjore dhe vendimit të Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë.

#### **Neni 8**

### **REGJISTRIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria tregtare deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky Statut si dhe të legjislacionit shqiptar në fuqi. Ajo konsiderohet e krijuar në datën e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR) sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007.

#### **Neni 9**

### **KALIMI I KUOTAVE**

Pjesët shoqërore të ortakëve përputhen me pjesën e tij në kapitalin e shoqërisë.

Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre

#### **Neni 10.**

### **ORGANIZIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria është e organizuar në organet e mëposhtëme:

**1- Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë**

**2- Administratoret.**

Kompetencat e ortakëve dhe administratorit të shoqërisë janë të parashikuara në ligj dhe në statutin e shoqërisë.

Administratore të shoqërisë caktohen:

**1-AURELDA SIMON XHAF**A, e datëlindjes 29.03.1993, lindur në SHales-Elbasan, banuese në Tirane, madhore, me zotësi të plote



juridike për te vepruar, pajisur me pasaporte personale për identifikim nr. BJ 0318705 dhe nr. Personal J 35329011H.

**2-MARJUS MINA MIHALI**, i datëlindjes 09.03.1993, lindur ne Bubullime-Lushnje, banues ne Tirane, madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me ID për identifikim, me nr. Personal J30309031D.

Te cilët caktohen per nje periudhe kohore 5-pese vjecare.

### **Neni 11**

#### **MARDHENIET E PUNES**

Marrëdhëniet e punës rregullohen nëpërmjet kontratës se punës dhe legjislacionit te punës ne fuqi. Shoqëria merr përsipër te respektoje rregullat ne fuqi te punësimit dhe te punësuarit janë te detyruar qe te respektojnë Statutin e kësaj shoqërie dhe rregullat e brendshme te saj. Te punësuarit duhet te përgjigjen për demet qe i shkaktojnë kësaj shoqërie nga veprimet ose mosveprimet e tyre sipas ligjit.

#### **KONFIDENCIALITETI, RUAJTJA E SEKRETIT**

### **Neni 12**

Konsiderohen si konfidenciale dhe nuk lejohet te behet publike përmbajtja e tyre për te tretet e te gjitha akteve dhe dokumenteve qe janë përcaktuar si te tilla nga administratori i shoqërisë.

#### **EKSPERTET OSE REVIZORET KONTABEL**

### **Neni 13**

Kontrolli mbi veprimtarinë e shoqërisë si dhe gjithë aktivitetin e shoqërisë i besohet një ekspertit ose revizori kontabël. Ky ekspert do te emërohet dhe qëndroje ne detyre sipas parashikimeve te ligjit përkatës. Ortaku cakton dhe shpërblimin përkatës kur nuk ka norma te veçanta ligjore.

### **Neni 14**

#### **Viti financiar dhe bilanci vjetor**

Viti financiar fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit. Administratori merr masat me qëllim hartimin e bilanceve, rezultateve ekonomike te fitimeve apo humbjeve dhe inventarizimin. Pas analizimit te çështjeve te mësipërme si dhe shlyerjen e detyrimeve, te ardhurat e



tjera do ti kalojnë ortakut te shoqërisë.

**Neni 15**  
**SHPERNDARJA DHE LIKUIDIMI I SHOQERISE**

Ne rast se shoqëria shpërndahe për çdo lloj arsye Ortaket përcaktojnë mënyrën e likuidimit, emëron një ose me tepër likuidator dhe përgatit te gjitha dokumentet e nevojshme për c 'regjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.

**Neni 16**  
**LIBRAT E SHOQERISE**

Po kështu shoqëria ne baze te ligjit mban librat e mëposhtëm:

- 1) Libri i Ortakut te Vetëm.
- 2) Libri i vendimeve te organit administrativ.
- 3) Libri i mbledhjeve dhe vendimeve te eksperteve ose revizoreve kontabël.

**Neni 17**  
**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

Persa është shprehur ne kete statut i referohemi ligjit 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe ligjit nr.9723. date 3.5.2007 "Per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit". Çdo ndryshim behet ne përputhje me ketë Statut dhe nuk prek personalitetin juridik te kësaj shoqërie.


Statuti është hartuar ne 4 kopje origjinale ne gjuhen shqipe .

**Data 11.01.2018**

**ORTAKET E VETEM TE SHOQERISE**

**Electro TECH"SH.P.K**

Aurelola Xhaba  
Anf.

Marjush Mihal  




**REPUBLIKA E SHQIPERË**  
**DHOMA E NOTERISE- TIRANE**  
**NOTERE.SHPRESA M GJOCI**

NR. 276 REP

### **AUTENTIFIKIM NENSHKRIMI**

Sot me daten 11.01.2018( dy mije e tetembehjete) une notere SHpresa M GJOCI, me seli ne Tirane, vertetoj se u paraqiten para meje personalisht :

**1-AURELDA SIMON XHAFA**, e datëlindjes 29.03.1993, lindur ne SHales-Elbasan, banuese ne Tirane, madhore, me zotësi te plote juridike per te vepruar, pajisur me pasaporte personale për identifikim nr. BJ 0318705 dhe nr. Personal J 35329011H.

**2-MARJUS MINA MIHALI**, i datëlindjes 09.03.1993, lindur ne Bubullime-Lushnje, banues ne Tirane, madhor, me zotësi te plote juridike për te vepruar, pajisur me ID për identifikim, me nr. Personal J30309031D.

Te sipërpërmendurit, deklaruan se statutin e mesiperme kane nënshkruar konform vullnetit te lire dhe e nënshkruan ne prani te noterit.

Une noterë ne baze te ligjit vërtetoj nënshkrimet e tyre te mesiperme.

NOTERE  
Shpresa M GJOCI

